



Prishtinë: 05.08.2010

Kodi i ZRRE-së: V_275_2010

Nr. i Referencës: ZRRE/DMK_V_430_06_10

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke marrë parasysh:

1. Kompetencat e Zyrës së Rregullatorit për Energji të dhëna në nenin 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë;
2. Dispozitat sipas Kapitullit 3, Nenit 17 të Rregullës mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
3. Dëshmitë e paraqitura nga palët;
4. Vendimin e DMK të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_V_430_06_10** ;
5. Apelimi i KEK-ut me datë 26.07.2010;
6. Nenin 18 të Rregullës mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë;

Në mbledhjen e mbajtur më 05 gusht 2010 nxori këtë:

VENDIM

REFUZOHET apelimi i KEK-ut për ankesën e konsumatorit Beqir Hoxha (shifra e konsumatorit DFE – 44434) nga Lipjani, si në arsyet e paraqitura të këtij vendimi.

Arsyetim

Konsumatori në ankesën e tij drejtuar DMK-së në ZRRE me datë 27.01.2010 ka apeluar përgjigjen e KEK Sh.A – Divizioni i Furnizimit – Departamenti për Konsumatorë të datës 19.01.2010 lidhur me kontestimin e ngarkesës së shfrytëzimit të paautorizuar.

- Me datë 05.01.2009 punëtorët e autorizuar të KEK-ut për inspektimin e pikave matëse kanë bërë inspektimin e pikës matëse të konsumatorit dhe kanë bërë ndërrimin e njehsorit elektrik, ku kanë hequr nga matja njehsorin elektrik nr. 34722382 dhe kanë vendosur për matje njehsorin elektrik nr. 4691360 dhe vulosur me vulë distributive A7 0025454.
Provë: Procesverbali i KEK-ut nr. 247206 të datës 05.01.2009
- Me datë 04.03.2009 punëtorët e autorizuar të KEK-ut për ndërrim njehsori kanë inspektuar pikën matëse të konsumatorit dhe kanë bërë ndërrimin e njehsorit elektrik, ku kanë hequr nga matja njehsorin elektrik nr. 34722382 dhe kanë vendosur për matje njehsorin e vet elektrik nr. 4691360.
Provë: Vërtetim mbi ndërrimin e njehsorit elektrik nr. 008460 datë 04.03.2009

- Me datë 06.04.2009 punëtorët e qendrës së kalibrimit kanë bërë kontrollimin detal të njehsorit elektrik nr. 34722382, ku është konstatuar se njehsori elektrik vulat (bllombat) shtetërore i ka në rregull, nga ana e jashtme njehsorit qelqi i mungon si dhe numëruesi i njehsorit është i manipuluar ka gjurmë të kthimit mbrapa të numrave në numëror.
Provë: Procesverbali me nr. 3/6 i datës 06.04.2009
- Me datë 26.05.2009 punëtorët e autorizuar të KEK-ut kanë inspektuar pikën matëse te konsumatori dhe kanë bërë regjistrimin e të dhënave teknike të pikës matëse.
Provë: Procesverbali i KEK-ut nr. 356741 i datës 26.05.2009
- Me datë 29.05.2009 KEK-u e ka ngarkuar konsumatorin me ngarkesë për shfrytëzim të paautorizuar me anë të faturës DFE09HP04414 në vlerë prej 2,248.64 €.
Provë: Fatura DFE09HP04414 e datës 29.05.2009
- Me datë 16.06.2009 konsumatori ka parashtruar ankesë në Departamentin për Konsumator në KEK duke kundërshtuar ngarkesën për shfrytëzim të paautorizuar të energjisë elektrike.
Provë: Ankesa e konsumatorit në KEK
- Me datë 19.01.2010 Departamenti për Konsumator në KEK i është përgjigjur konsumatorit duke e refuzuar dhe duke thirrur në procesverbalin e kontrollës dhe të kalibrimit.
Provë: Përgjigja e KEK-ut e datës 19.01.2010
- Me datë 27.01.2010 konsumatori ka apeluar përgjigjen e KEK-ut në DMK të ZRRE-së.
Provë: Ankesa e konsumatorit në DMK të ZRRE-së

Bordi i ZRRE-së ka analizuar Vendimin e lëshuar nga DMK: ZRRE/DMK_V_ 430_06_10 dhe ka konstatuar se vendimi është në pajtim me Rregullat e ZRRE-së. Apeluesi (KEK-u) nuk ka ofruar ndonjë dëshmi shtesë kundër këtij Vendimi, andaj Bordi i ZRRE-së ka vendosur ta **refuzojë** KEK-un për arsyet e paraqitura në vendimin e DMK të ZRRE-së.

Këshillë Juridike: Kundër këtij Vendimi, pala ka të drejtë të iniciojë procedurë gjyqësore në Gjykatën Kompetente, brenda **katërmëdhjetë (14) ditësh** prej ditës së pranimit të këtij Vendimi.

Bordi i ZRRE-së

Dr. Ali Hamiti, kryesues

Theranda Beqiri, anëtare

Përparim Kabashi, anëtar

Blerim Koci, anëtar